

# DIELLI YNË MBAN



# EMRIN DEMOKRACI

## DEMOKRACIA NË RITJE

BLENDINA (11), JON (10), MILON (11), DARLINA (11), FATBARDH (11), DRENA (10), ANTIAN (11),  
ALBEM (10), MELOS (11), ARENA (10), VILËZA (10), ELIRA (11)



**Që nga koha kur u shfaq për herë të parë, demokracia si sistem pësoi shumë ndryshime. Për këto ndryshime do të informoheni tek artikulli ynë**

Çka është demokracia dhe si është zhvilluar ajo?

Demokracia është formë e qeverisjes, përmes së cilës udhëheqja shtetëror rrjedh nga populli. Fjala “demokraci” vjen nga gjuha greke, prej nga edhe ka lindur apo thënë më mirë është shfaqur për herë të parë. „Demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë rend apo qeverisje. Ky sistem është shfaqur në vitin 507 p.e.s. Që nga ky vit, demokracia u bë një ndër sistemet më të preferueshme për qeverisje. Këtë e dëshmon më së miri fakti që shumë shtete filluan të funksionojnë sipas këtij sistemi. Duke përfshirë këtu edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në Evropë ky sistem bëhet më i pranueshëm pas vitit 1945, vit në të cilin edhe përfundoi Lufta e Dytë Botërore. Edhe pse shumica e shteteve të botës funksionojnë në bazë të këtij sistemi, prapsepapë ato dallojnë disi nga njëra-tjetra. Ajo

çka i bën të dallojnë është forma e demokracisë të cilën mund ta kenë këto shtete. Dy llojet kryesore të demokracisë janë: përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Në këtë të fundit qytetarët marrin vendime përmes referendumeve. Kurse, në demokracinë përfaqësuese vendimet merren nga përfaqësuesit e popullit që në këtë rast janë deputetët.

Nëse kthehemi tek viti kur është shfaqur demokracia dhe e bëjmë një krahasim mes asaj demokracie dhe kësaj të sotmes vërejmë që ndryshimet janë shumë të mëdha. Këto janë ndryshime pozitive dhe që kanë gjetur përkrahje shumë të madhe nga qytetarët, si për shembull, mosdiskriminimi i gjinisë femërore, trajtimi në mënyrë të barabartë i të gjithë qytetarëve. Ne mendojmë se ende ka vend për përmirësime. Pra, me kalimin e kohës ka pasur ndryshime që kanë pasur efekte pozitive për shoqëritë demokratike. Andaj, të vazhdojmë të punojmë për t'i ruajtur të gjitha elementet e demokracisë.




Sot ishte ditë shumë e veçantë për të gjithë ne

Elementet pa të cilat demokracia asnjëherë nuk do të mund të funksiononte janë: barazia, liria, paqja, toleranca, respekti, etj.

Parimi i barazisë nënkupton se të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe duhet të gëzojnë mundësi të barabarta për t'u zhvilluar. Për neve si fëmijë është shumë e rëndësishme, që edhe qytetarët të cilët nuk e kanë statusin e lartë ekonomik, të trajtohen sikurse ata që e kanë statusin ekonomik më lartë. Këtë e diskutuam edhe brenda grupit, kur shoku ynë Albemi e ndau me ne një rast. Ai kishte qenë në


një market në lagjen e tij. Personat që ishin përgjegjës për të ndihmuar blerësit rreth produkteve të marketit kishin hezituar t'iu ofronin ndihmë disa burrave që nuk mund ta lexonin vitin e skadimit të produkteve. Ai tha që ishte ndjerë shumë keq dhe që kurrë në jetën e tij nuk do të dëshironte të përjetonte prapë të njëjtën ndjenjë. Disa elemente të tjera i kemi paraqitur tek pema që e ka vizatuar shoku ynë Melosi. Për këtë edhe kërkoj nga ne që nëse ndonjëherë rastisemi në këso situata të veprojmë e jo vetëm të shikojmë. Këtë e do demokracia, e kjo është qytetaria aktive.



**Edhe vota e lirë është element i demokracisë. Mund të themi se është një ndër më kryesoret. Për votën, shembullin e ka shkruajtur, grupi që e ka diskutuar këtë temë**

Klasa jonë kemi votuar shumë herë. Njëherë kemi votuar për një aktrim në klasë. Mësuesja na ndau në gjashtë grupe. Të gjithë morrëm nga një lodër dhe aktruam me to. Aktruam shumë mirë.

Të gjithë nxënësit votuan dhe zgjodhën grupin i cili aktroi pak më mirë se të tjerët. Në fund fitoi grupi i dytë me temën "Në fshat". Në këtë rast ne u ndjemë shumë mirë, pasi që të gjithë jemi të barabartë. Siç e thamë edhe më lart, demokracia për ne është forma më e mirë e udhëheqjes, sepse ajo na ofron hapësirë për të shprehur mendimet tona lirshëm.




Demokracia na bashkon dhe na afron me njëri-tjetrin

Unë zgjedh shumë gjëra në jetën e përditshme

## NE JEMI QYTETARË AKTIV TË KOSOVËS

VALDET (10), DALMAT (10), TAULANT (11), SHEND (10), ERISA (10), EDIS (11), KLEA (10), ADONIA (10)

LEO (10), ADISA (10), AULONA (11)



**A e keni menduar ndonjëherë se kush është qytetar i Republikës së Kosovës? A e dini se ku qëndron dallimi mes qytetarëve? Këto përgjigje do t'ua tregojmë ne**

Qytetarë jemi të gjithë ne të cilët jetojmë brenda kufijëve të një shteti të caktuar dhe kemi leje qëndrim. Ne dallojmë për nga pamja jonë e jashtme, dallojmë për



nga mendimet që i kemi, kemi preferenca të ndryshme, vishemi ndryshe, por kjo nuk e përcakton mënyrën se si ne duhet të trajtohemi. Pa marrë parasysh dallimet individuale që i kemi, ne duhet të trajtohemi të gjithë të barabartë. Kjo i bie se dallimi mes qytetarëve nuk qëndron tek mënyra se si ata janë, por tek aktivizimi i tyre. Kjo bën qytetarët të ndahen në aktiv edhe pasiv. Për të treguar se kush është qytetarë aktiv po e marrim shembull veten tonë.

Qytetarët aktiv si ne: marrin pjesë në OJQ, tregohen aktiv për komunitetin e tyre, i respektojnë elementet

e demokracisë, iu ndihmojnë të varfërve dhe të mos-huarve, marrin pjesë në votime kur ta mbushin mos-hën e paraparë me ligj dhe kujdesën për ambientin. Po ashtu, në të ardhmen ne do të paguajmë taksat dhe do të protestojmë kur ta shohim të arsyeshme.

Por, lexues të dashur na vie shumë keq, që nuk mund ta gjejmë ndonjë shembull për qytetarët pasiv momentalisht, sepse nuk kemi parë raste të tilla deri më tani. Shpresojmë të mos ndeshemi në shembuj të këtij lloji. E nëse shohim raste të tilla, do të bëjmë thirrje publike që të gjithë të bashkangjiten në grupin e qytetarëve aktiv. Sepse vetëm kështu zhvillohet sistemi më i mirë i qeverisjes që është demokracia.


Andaj, kontribuoni për shtetin tonë që të keni një të ardhme më të mirë. Nëse ju nuk e bëni këtë, kush mund ta bëjë për ju? Mos harro, çdo gjë fillon nga ti! Ke pushtet dhe përdore mirë atë.



Aktiv dhe me të drejta të barabarta

## VOTA NA PËRKET NE

ART (10), BLEARD (11), XHIM (11), NDRIT (11), RON (10), GENT (11), EJOTA (11), GERTA (10),  
ERA B. (10), ERA K. (10), SUMEJA (11), DENISA (11)



### Titulli i artikullit tonë thotë se vota na përket ne. Por, si votojmë ne? Këtë do ta mësoni më poshtë

Ne jemi nxënësit e klasës V-6 dhe sot kemi mësuar për zgjedhjet. Fillimisht ne diskutuam për demokracinë. Kur një shtet mund të udhëheqet nga shumë njerëz, kjo udhëheqje quhet demokraci. Kurse një shtet që udhëheqet nga një njeri quhet autokraci. Neve na pëlqen demokracia më shumë, sepse aty mund të shprehim lirshëm mendimet tona. Ne si qytetarë në demokraci kemi shumë të drejta. Disa nga të drejtat tona janë: e drejta e jetës, e drejta e strehimit, e drejta e të ushqyerit, veshmbathja, e drejta e shkollimit, e drejta e argëtimit, etj.

Secili nga ne do që ta shpreh lirë mendimin e tij dhe kjo duhet t'i lejohet çdo kujt. Përveç kësaj, një të drejtë të veçantë që e ka çdo qytetar në demokraci është e

drejta e votës. Në Kosovës kemi dy lloje të zgjedhjeve dhe ato janë: zgjedhjet parlamentare (qendrore) dhe zgjedhjet komunale (lokale). Në Kosovë jetojnë rreth dy milionë banorë, të cilët sapo mbushin moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të votojnë për 120 deputetë të Kuvendit të Kosovës. Këto quhen zgjedhje parlamentare. Ndërsa, zgjedhjet ku ne zgjedhim kryetarin e komunës dhe asamblistët quhen zgjedhje lokale.

Qytetarët japin mendimet e tyre për këta përfaqësues. Kurse këta përfaqësues punojnë për ne. Arsyeja pse ne duhet të votojmë kur kemi 18 vjet ose më shumë, është se ne atëherë jemi mjaftueshëm të pjekur. Gjithashtu jemi të pavarur e të rritur. Ne vendosim vetë për veten tonë, për veshjen tonë, lojën që do ta luajmë, apo gjërat e tjera të cilat i bëjmë. Të drejtat për neve janë shumë e rëndësishme.



Kënaqësi e veçantë të jemi pjesë e „Demos-ti“



Vetëm duart tona bëjnë punë të mrekullueshme



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hasan Prishtina“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-6  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë